

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË ARTEVE

1.METODA “TURI I GALERISË”

Në orën mësimore të lëndës “Art pamor”, klasa IXB, me temë mësimore ‘Dizajni i tekstileve’ dhe me koncept kryesor ‘Nxënësi krijon nëpërmjet tezgjah-ut’ u përdor metoda e turit të galerisë, e parashikuar në planin e orës mësimore, e cila më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Klasa u nda në 2 grupe sipas rreshtave në klasë të vendosur.
- Secili nga nxënësit, të cilët kishin nga një mini tezgjah të vogël në dorë, përzgjedhën ngjyrat e preferuara që të krijonin një mini rrugicë.
- Ata punuan të pavarur të shoqëruar në sfond me muzikë instrumentale, shqiptare duke kënduar njëzëri, u angazhuan secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësuese i kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 15 minuta.
- Pas përfundimit të punimit, rreshti i parë u ngrit dhe pa punimet e secilit/ës nxënës/e të rreshtit të dytë dhe anasjelltas, si dhe e gjithë kjo veprimtari u shoqërua me muzikë.
- Më pas, rreshti i parë komentoi punimet e shokëve dhe shoqeve duke vlerësuar anët pozitive të realizuara dhe disa këshilla se si mund të bëhej më mirë tezgjahu. Disa prej nxënësve dhanë komentet e tyre dhe kështu veproi edhe rreshti i dytë duke komentuar punimet e rreshtit të parë.
- Kështu nxënësit përforcojnë konceptet kryesore të temës së re, duke komentuar vetë por edhe duke dëgjuar mendimin e shokëve.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e turit të galerisë sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë dhe gjithashu u jepet mundësia të njohin mirë njëri-tjetrin dhe karakteristikat e gjithësecilit.

Mësuesja e Artit pamor: **Sonila Mehmeti**

s.mehmeti@gea.edu.al

2.METODAT “TË PYETURIT” DHE “PUNË INDIVIDUALE”

Në orën mësimore me klasën e 7A u zhvillua tema “Nota 1/16”. Për të trajtuar temën e re, rikujtuam bashkë me nxënësit të gjitha vlerat e notave muzikore të mësuara nga temat e mëparshme. U ndoq kjo procedure:

- U bënë pyetje të parapërgatitura në mënyrë që nxënësit të kalonin shumë natyrshëm nga e njohura tek e panjohura lidhru me vlerën e notës 1/16. Për të sqaruar dhe për të qenë i përvetësuar ky koncept nga nxënësit na ndihmuan dhe aftësitë e tyre për vlerat e thyesave nga lënda e matematikës.
- Secili/a nxënës/e u ngrit në *smartboard* për të plotësuar ushtrimin e përgatitur, plotësimi i të cilit dëshmonte se sa ishte përvetësuar koncepti i trajtuar.
- Ora e mësimit vazhdoi me një detyrë klase dhe pas përfundimit çdo detyrë u vlerësua.

Ua sugjeroj kolegëve të mi të përdorin sa më shpesh këtë ndërthurje të metodave të cituara më sipër, sepse ajo kombinimi i tyre krijon ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesi i muzikës: Endri Llaha

endri.llaha@gea.edu.al

3.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës “Art pamor”, klasa e 5B me temë mësimore "Maket me karton i një hapësire të brendshme" dhe me koncept kryesor bashkëpunimin, diskutim/krijimin e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që pjesa më e madhe e nxënësve të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Mësuesja organizoi klasën në grupe me nga 3 ose 4 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për anëtarët e tij, si dhe secili grup u pajis me karton, shënjes me ngjyra/markers, baltë/letër të ricikluar, vizore, bojëra, penela, lapsa me ngjyra, ngjitës letre etj.
- Secili grup punoi për detyrën e kompozimit, pikturës, vizatimit, zbatimit të skicës dhe ndërtimit të maketit . Nxënësit punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësues/e kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 5 minuta, u vu re që ekspozita e tyre ishin mbresëlënëse dhe u arrit rezultati i të nxënë, që ishte vendosur për atë koncept të orës mësimore.

Për një bashkëpunim dhe përfshirje të lartë të nxënësve do ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe

Mësuesja e Artit pamor: Aurela Prifti

aurela.prifti@gea.edu.al

4. TEKNIKA “LOJË MUZIKORE “

Në orën mësimore të lëndës Muzikë, klasa e tretë , me temë mësimore “Ritmi në muzikë” teknika lojë muzikore , e parashikuar në planin e orës mësimore, bëri të mundur që nxënësit të përfshiheshin në mësim dhe të kuptonin lehtësisht konceptin “Ritëm” dhe ta vendosnin në praktikë atë që mësuuan

Teknika u zbatua në këtë mënyrë:

- Klasa u nda në tre grupe .Secilit grup iu përcaktua një figurë ritmike, fillimisht e realizuar me fjalë pyetëse dhe përgjigjja e pyetjes.Kush është këtu ? Unë jam këtu .
- Duke ia përshtatur figurën ritmike fjalëve, secili grup përgjigjej në bazë të pyetjes që bënte mësuesi me ritmin e caktuar .
- Secili grup arriti të evidentonte figurat e përcaktuara, ritmike dhe më pas atyre iu kërkua realizimi i ritmeve pa përdorur fjalët por vetëm shuplakat .

Kjo teknikë padyshim që i ndihmoi shumë nxënësit duke rritur përqendrimin e tyre por edhe duke i argëtuar pa masë .

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh teknikën “Lojë muzikore” pasi përveç se krijon një atmosferë të gëzueshme në klasë, rrit shkallën e përfshirjes së nxënësve dhe mbi të gjitha mundëson që nxënësit ta kuptojnë më lehtë ritmin si koncept dhe realizimin e figurave ritmike të ndryshme në mënyrë më të shpejtë dhe të efekshme .

Mësuesja e edukimit muzikor: Klaudia Hazizanj
klaudia.hazizanj@gea.edu.al

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË EDUKIMIT FIZIK DHE SHËNDETSOR

1.METODA “ PUNË INDIVIDUALE”

Në orën mësimore të lëndës së edukimit fizik, klasa e VI, me temë mësimore “Circuit gjimnastikor me elementë të kapërdimjes para” dhe me koncept kryesor zhvillimin e aftësive motorike dhe teknike të kapërdimjes u përdor metoda e punës individuale, e cila mundësoi që secili nxënës të angazhohej në mënyrë të pavarur. Kjo metodë u zbatua në këtë mënyrë :

- Mësuesja organizoi dhe i sqaroi në mënyrë të detajuar hapat e ushtrimeve që do të zbatonte dhe ndiqet secili nxënës/e, duke e demonstruar dhe vetë. .
- U përgatit një circuit me pajisje dhe shenja udhëzuese duke nisur me kalimin ndermjet tyre të disa piketave
- Më pas kapërdimje para në dyshekun e parë
- Kalimin e pengesa të ulëta
- Vendosja e disa rrathëve gjimnastikorë dhe kalimi i tyre me majat e gishtave
- Kapërdimje në dyshekun e dytë.

Çdo nxënës i realizoi ushtrimet në mënyrë individuale duke respektuar rradhën dhe duke ndjekur udhëzimet e dhëna. Procesi i kryerjes së circuitit zgjati rreth 5 minuta gjithsej, ndërsa unë si mësuese monitorova dhe ofrova udhëzime për përmirësimin e teknikës ku ishte e nevojshme. Gjatë orës mësimore u vu re një përkushtim i lartë nga nxënësit , të cilët punuan me seriozitet për të arritur rezultatin e paracaktuar. Metoda e punës individuale i ndihmoi nxënësit të përqëndroheshin në zhvillimin e aftësive të tyre personale, duke u dhënë mundësinë për të përmirësuar teknikat e kapërdimjes.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin metodën e punës individuale, sepse i ajo ndihmon në vlerësimin e aftësive të secilit nxënës dhe krijon një angazhim të lartë, individual në të nxënës.

Mësuesja e edukimit fizik dhe shëndetsor: Xhuljana Adili xhuljana.adili@gea.edu.al

2. METODA “ PUNË INDIVIDUALE”

Në orën mësimore të lëndës së edukimit fizik, klasa e V, me temë mësimore “Atletikë :Circuit me vrapime me ndryshim drejtimi e kalim pengesash” dhe me koncept kryesor

zhvillimin e aftësive motorike dhe teknike të nxënësve, metoda 'punë individuale' e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që secili nxënës të përfshihej në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë :

- Mësuesja organizoi dhe i sqaroi në mënyrë të detajuar nxënësit për të realizuar circuitin individualisht
- U përgatit pista me shenja për orientim, duke nisur me vendosjen e disa piketave për kalimin me majë të gishtave të tyre, vendosjen e pengesave të larta për kalimin poshtë të tyre duke vazhduar me disa piketa të tjera për të realizuar vrapimin zig-zag për të përfunduar me kalimin e pengesave të ulëta .
- Nxënësit demonstrojnë individualisht dhe treguan një angazhim të plotë në realizimin e detyrës së tyre, kurse unë si mësuese monitorova dhe ndihmova aty ku ishte e nevojshme.
- I gjithë circuiti u realizua brenda 5 minutave.

Gjatë realizimit të circuitit u vu re përkushtimi dhe angazhimi i nxënësve për të arritur rezultatin e orës mësimore, por dhe duke përmirësuar aftësitë e tyre, fizike dhe teknike lidhur me ushtrimin e paravendosur.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin metodën e punës individuale, sepse i ajo ndihmon në vlerësimin e aftësive të secilit nxënës dhe krijon një angazhim të lartë, individual në të nxënë.

Mësuesja e edukimit fizik dhe shëndetsor: Xhesila Metalla xhesila.metalla@gea.edu.al